


**Shtojca 2****Aplikacion për dhënien e lejes mjedisore**

| <b>APLIKACION PËR DHËNIEN E LEJËS MJEDISORE</b> |  |  |
|---|--|--|
| <b>1. TE DHËNAT E PËRGJITHSHME</b>              |  |  |
| <b>1.1. Të dhënata për operatorin</b>           |  |  |
| 1.1.1.  | Emri i subjektit   | BENITA COMPANY SH.P.K.   |
|   | Vendi  | Vërbnicë -Mitrovicë,   |
|   | Adresa   | Gremnik -Klinë   |
|   | Nr. i tel./fax   | +383 49 777 483  |
|   | E-mail   | <a href="mailto:armendprekadini@hotmail.com">armendprekadini@hotmail.com</a>     |
| 1.1.2.  | Numri i regjistrimit të biznesit,<br>data e regjistrimit | 810313213, 06/08/2003  |
| 1.1.3.  | Personi përgjegjës i kompanisë                           | Armend Prekadini Master i Xehetarisë   |
|   | Nr. i tel./fax   | +383 49 777 483  |
|   | E-mail   | <a href="mailto:armendprekadini@hotmail.com">armendprekadini@hotmail.com</a>     |
| 1.1.4.  | Personi kontaktues përgjegjës për<br>mjedis              | Armend Prekadini   |
|   | Nr. i tel./fax   | +383 49 777 483  |
|   | E-mail   | <a href="mailto:armendprekadini@hotmail.com">armendprekadini@hotmail.com</a>     |
| <b>1.2. Të dhënata për impiantin</b>            |  |  |
| 1.2.1.  | Emri i impiantit   | “BENITA COMPANY“ SH.P.K.<br>Shfrytëzimi i gurit Gëlqeror në Vërbnicë -Mitrovicë, |
| 1.2.2.  | Adresa e lokacionit të impiantit                         | Zona Vërbnicë Mitrovicë  |

## 2. TË DHËNAT PËR LOKACIONIN E IMPIANTIT

|     |  |   |
|-----|--|---|
| 2.1 | Të dhënat për lokacionin ku zhvillohet veprimtaria sipas hartës së bashkangjitur | Zona Vërbinicë Mitrovicë  |
| 2.2 | Numri kadastral i parcelës   | Nr. 6, 7, 8, 10, 11 dhe nr.18, Fleta poseduese nr. 125, Zona kadasrale Vërbinicë – Mitrovicë.   |
| 2.3 | Përshkrimi i lokacionit të gjitha objektet dhe aktivitetet e tyre në atë zonë    | <p>ndodhet rrëth 1 km, ne veri të rrugës automobilistike që lidh Pejen me Mitrovicë.</p> <p>Fshatrat me të afert të zones Vërbinicë, Lushta Rosule, Gradefci por qe të gjitha ndodhen mbi 700m Larg Gurores ton.</p> <p>Rajoni i vendburimit të gelqerorëve Vërbinicë-Mitrovicë (Foto1) bën pjesë në krahinen e Mitrovicës dhe ndodhet rrëth 8 km. Larg qytetit Mitrovicë.</p> <p>Administrativisht i perket Komunes Mitrovicë, vete vendburimi i Gëlqerorve.</p> |

|          |   |  |
|----------|---|--|
| 2.4<br>. | Të dhëna lidhur me florën dhe fauna në atë lokacion | <p>Ajo që dallon florën dhe faunën e këtij regjioni janë ndryshimet intensive si pasojë e veprimtarisë së njeriut. Problematika e gjendjes ekzistuese të llojeve bimore nuk është studiuar në masë të mjaftueshme për të sjellë përfundime meritore, mirëpo në bazë të shqyrtimeve vizuale në rrithin të zonës më të largët ku realizohet projekti kemi hasur në bimësi që karakterizohet kryesisht nga bimët e ulta barishtore, kultura periodike bujqësore si dhe të gjitha pemët frutore të grupit faror dhe atyre bërthamore. Pyjet e këtij regjioni kryesisht janë pyje të llojit gjethor dhe përbëjnë një numër të madh të llojeve, si që janë bungu ,qarri ,ahu si dhe bredhi i kultivuar etj. me rritje të ulta dhe mesatare.</p> <p>Bazuar në florën ekzistuese dhe kushtet klimatike të rajonit të Mitrovicës e duke marrë për bazë edhe të dhënat nga vendasit, përpos kafshëve dhe shpezëve shtëpiake që i posedojnë fshatarët, në rrithin të kësaj zone, jetojnë gjitarët , zvarranikët , brejtësit , insektet e ndryshme, lepuri i egër, dhelpra, ujku, iriqi, etj. Ndërsa prej shpezëve janë karakteristike: bilbilat, thëllëza e fushës, sorrat, shqiponja, etj.</p> |
| 2.5<br>. | Të dhënat mbi zonat e veçanta të mbrojtjes          | Në afërsi dhe më gjërë nuk ka të dhëna për ekzistimin e zonave të veçanta të mbrojtura nga institucionet e R. Kosovës  |

| 3. PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE MBI VEPRIMTARINË                      |                              |  |
|---|------------------------------|--|
| 3.1. Përshkrim i aktivitetit për të cilën kërkohet leja mjedisore |                              |  |
| 3.1.1.  | Skema e procesit teknologjik |  <p>1) Ekskavatori Libherr 944<br/>2) Kamjoni Mercedes Actros</p> <p>Fig. 1. Paraqitura skematike e procesit tekologjik për shfrytëzimin e gurit</p> |

|        |  |  |
|--------|--|--|
|        |  |  |
| 3.1.2. | Përshkrim i pajisjeve dhe fazat e procesit teknologjik | <p>Përshkrimi i paisjeve për shfrytezim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Makina shpuse TAMROCK 1100</li> <li>- Ekskavatori LIEBHERR 944</li> <li>- Ekskavatori LIEBHERR 934</li> <li>- Luga ngarkuese LIEBHERR 574</li> <li>- Kamioni MERCEDES (Actros)</li> <li>- Thermusi primare</li> <li>- Thermusi sekondare</li> </ul> <p><b>Shfrytëzimi i Gëlqerorve ne zonë Vërbnicë-Mitrovicë</b><br/> Ndikim vendimtar në hapjen e vendburimit kanë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Pozita gjeografike,</li> <li>- Parametrat gjeometrik të vendburimit,</li> <li>- Thellësia, rënia, trashësia, shtrirja, etj.</li> </ul> <p><b>Hapja dhe krijimi i fronteve të shfrytëzimit</b><br/> Gjeometrizimi i karierës karakterizohet me hapjen dhe krijimin e secilës shkallën veç e veç, duke filluar nga lartë-poshtë. Procesi teknologjik i shfrytëzimit të gëlqerorit është i njëjtë për të gjitha shkallët. Punimet e shfrytëzimit të gurit gëlqeror në këtë vendburim zhvillohen sipas projektit krysor të Xehetarisë ku janë përcaktuar të gjithë parametrat teknik-teknologjik për shfrytëzim:</p> <p>Parametrat kryesor teknologjik të shkallës në guoren tonë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Lartësia e shkallës (<math>h=10m</math>),</li> <li>- Këndi i pjerrësisë së shkallës (<math>\alpha=70-80^\circ</math>),</li> <li>- Këndi gjeneral i shpatit punues dhe përfundimtar (<math>\beta=47^\circ</math>),</li> <li>- Gjerësia e bermes (<math>b=4-5m</math>) dhe transportues (<math>b_1</math>).</li> <li>- Hapja e karrierës është bër duke u nisur nga kuota fillestare e vendburimit nga lartësia ne nivelin e kuotës +850m dhe nga thëllësia ne nivelin e kuotës të shkallës +720m, me disniveli 130m.</li> </ul> |

|        |  |   |
|--------|--|---|
|        |  | <p><b>Fazat e procesit teknologjik:</b></p> <p>Procesi i prodhimit në gurthyesin “BENITA COMPANY” SH.P.K Zona Vërbnic – Mitrovicë Përbëhet katër procese të punës:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Punimet e shpimit-rrëzimit.</li> <li>- Punimet e ngarkimit.</li> <li>- Punimet e thërmimit dhe klasifikimi i gurit gëlqeror</li> <li>- Punimet e stivimit.</li> </ul> <p>Vlen të ceket se vendburimi i gëlqerorëve ka mbulesë të vogël, prandaj edhe stivimi i këtij materiali është në përmasa minimale, por nuk përashtohen mundësitet që edhe pjesa më e madhe e tij të përdoret.</p> <p><b>Punimet e shpimit-rrëzimit;</b> Para fillimit të shpimit duhet bër pregaditja e fushes për shpim (prerja e shkurreve, drunjve, etj.), pastaj behet shpiminimi, grumbullimi i materialit të minuar (madhësi 0-600-1200 mm) në platon bazë,</p> <p><b>Punimet e ngarkimit;</b> realizohet me anën e ekskavatorve ose me lugë ngarkuse pas minimit.</p> <p><b>Punimet e thërmimit dhe klasifikimi i gurit gëlqeror;</b> Zbrasja ne bunkerin pranusë të thërmuses mobile realizohet me kamiona apo direkt nga luga e ekskavatorit.</p> |
| 3.1.3. | Numri i orëve të punës dhe ditëve të punës gjatë javës për kryerjen e aktiviteteve | Punohet, 6 ditë brenda një javë, 1 ndrrim, nga 8 orë për një ndrrim. Gjithsej, 48 orë në javë.  |
| 3.1.4. | Kapaciteti i projektuar dhe kapaciteti i realizuar, ditor, mujor, vjetor           | <p>Kapaciteti i prodhimit ditor,mujor dhe vjetor mvaret nga shumë faktor, por nr kushte normale ai është :</p> <p>I projektuar</p> $Q_{Ditor} = 160 [m^3/h]$ $Q_{Mujor} = 4166 [m^3/m]$ $Q_{Vjetor} = 50000 [m^3/vit]$ <p>I realizuar</p> $Q_{Ditor} = 160 [m^3/h]$ $Q_{Mujor} = 4160-4170 [m^3/h]$ $Q_{Vjetor} = 49920-50040 [m^3/h]$  |

|        |  |   |
|--------|--|---|
| 3.1.5. | Të dhënrat për shfrytëzimin e lëndës së parë dhe lëndëve ndihmëse. | <p>Lënda e parë është guri gëlqeror, karakterizohet me veti: fiziko-mekanike, kimike, mineralogjike, dhe petrografike të mira, gjenë përdorim në : ndërtimtari dhe shtruarjen e rrugëve.</p> <p>Lëndët ndihmëse për përfitimin e gurit gëlqeror: energjia elektrike TS 10(20)/0.4kV, lëndë eksplozive , fitil detonus,kapsolla, ngadalësues ms vajra, kurora shpuese, shufra shpuese, goma për ngarkues, goma për autokamion, nafta dhe uji.</p>  |
| 3.1.6. | Lista e rezervuarëve dhe kapaciteti i tyre                         | <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Rezervari i ujit me kapacitet prej 3500litra</i></li> <li>- <i>Rezervari i ujit me kapacitet prej 1500litra</i></li> </ul>  |
| 3.1.7. | Lista e legjisacionit ne fuqi                                      | <p>Lista e Ligjeve dhe Udhëzimeve Administrative për kompletimin e kërkesës për lëshimin e lejes mjedisore</p> <p>Ligjet</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025</li> <li>• Ligji për Mbeturina Nr. 04/L-060</li> <li>• Ligji për planifikim hapësinor Nr. 04/L-174</li> <li>• Ligji për tokën bujqësore Nr. 02/L- 26</li> <li>• Ligji për mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L-102</li> <li>• Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147</li> <li>• Ligji për ndërtim Nr. 04/L-110</li> <li>• Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja Nr. 03/L-160</li> <li>• Ligji për mbrojtjen e natyrës Nr.03/L-233</li> </ul> <p style="text-align: center;"><b>Udhëzimet Administrative</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Udhezimi Administrativ për Leje Mjedisore MMPHI Nr.04/2022</li> <li>• Udhëzimi administrativ Nr.07/2017 për Lejen Mjedisore;</li> <li>• Udhëzimi administrativ (QRK)-Nr.03/2021 për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme;</li> <li>• Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 07/2021 për rregullat dhe normat e shkarkimeve ne ajër nga burimet e palëvizhshme të ndotjes;</li> <li>• Udhëzimi administrativ Nr. 05/2011 për metodologjinë e</li> </ul> |

|  |  |   |
|--|--|---|
|  |  | <p>vlerësimit të rrezikut nga aksidentet kimike si dhe masat për eliminimin e pasojave;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Udhëzimi administrativ (QRK) Nr. 08/2017 për menaxhimin e deponive të mbeturinave;</li> <li>• Udhëzimi administrativ Nr. 02/2019 për export, import dhe transit të mbeturinave;</li> <li>• Udhëzimi administrativ Nr. 01/2017 për cilësinë e karburanteve të lëngëta të naftës;</li> <li>• Udhëzimi administrativ Nr.30/2014 përkushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese te shkarkimit të ujrale të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujor;</li> <li>• Udhëzimi administrativ Nr. 04/2018 për Pengimin e aksidenteve të mëdha ku përfshihen substancat e rrezikshme.</li> </ul> |
| <p><b>3.2. Menaxhimi i Mbrojtjes së Mjedisit</b></p> |  |   |

|        |   |   |
|--------|---|---|
| 3.2.1. | Sistemi menaxhues i mbrojtjes së Mjedisit | <p>Programi i monitorimit parashihet një program duke berë aplikimin e teknikave më të mira në disponim për procese të prodhimit sipërfaqesor, me qëllim të mbrojtjes së mjedisit që përfshihen në Direktiva IPPC.</p> <p>Menaxhimi i mbrojtjes së mjedisit bëhet në tre fazat e operimit të gurorës:</p> <p>hapjes, shfrytëzimit dhe mbylljes gurorës. Monitorimi i ajrit, tokës dhe ujit, bëhet me marrjen e mostrave dhe kryrjen e analizave në institute adekuate.</p> <p style="text-align: center;">•</p> |
| 3.2.2. | Raportimi                                 | <p>Bëhen nga udhëheqjeja, gjegjësisht nga ekspertët e kompanisë “Benita Company” sh.p.k.. sa her qe kerkohët, ku do të paraqiten të dhënrat relevante nga të gjitha monitorimet e bëra, të cilat do të raportohen në Minsitri të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.</p>   |

| <b>4. AJRI</b> |   |  |
|----------------|---|--|
| 4.1.           | Pikat e burimit të emisioneve e materieve ndotëse   | Pikat më të rëndësishme të emisionit të pluhurit në “Vërbncië” janë: shpimi, minimi, ngarkim-shkarkimi, era, transporti, thërmimi primar dhe vibro sitat. Ndërsa ndotja e ajrit nga gazrat është në fazën e : minimit, dhe lëshimi i gazrave nga mekanizmat e rëndë që përdorin lëndët fosile(nafta dhe vajrat).   |
| 4.2            | Ndikimi i materieve ndotëse në cilësinë e ajrit     | Ndikim ne ndotjen e ajrit vjen edhe gjatë lirimt të gazrave, makinerit qe bejn grryrjen, ngarkimin dhe transportin si lëndë djegëse përdorin derivatet e naftës.<br><br>Përbërja e gurit gëlqeror në shfrytëzim nuk përmban materie të dëmshme.  |
| 4.3.           | Burimet difuzive të emisioneve të materieve ndotëse | Shpimet, minimi, ngarkimi, shkarkimi dhe transportimi i gurit gëlqeror.  |
| 4.4.           | Pajisjet për trajtimin e gazrave shkarkuese         | Nëse merret parasysh që 50% të gazrave gjatë minimit resporbohen nga shkëmbi, kurse pjesa tjeter defondohet në hapësirën e minierës, atëherë mund të konstatojmë se këto gazra nuk paraqesin rrezik as për të punësuarit në minierë e lëre më në mënyrë. Nuk ka nevojë për pajisje për trajtimin e gazrave, mjafton mirëmbajtja e rregullt, e mirë e mekanizmave të rëndë. |

|      |  |   |
|------|--|---|
| 4.5. | Pajisjet për depluhurin                    | <p>Për të parandaluar e zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në ajër, gjatë procesit teknologjik ,përpos masave të lartë cekura janë ndërmarr edhe këto masa:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Bëhet spërkatja me ujë ne trasen e transportit deri te deponija</li> <li>• Bëhet spërkatja me ujë e sipërfaqes operacionale</li> <li>• Bëhet mirëmbajtja e rregullt e pajimevedhe stabilimenteve të cilat janë burim i emisioneve të pluhurit.</li> <li>• Bëhet kontrollimi i rregullt teknik i automjeteve të rënda dhe konsumuesve tjerë të lëndëve të lëngëta djegëse me qëllim që lirimi i gazrave nga mjetet e punës të jetë sa më kualitativ.</li> <li>• Gjithmonë bëhet spërkatja e sipërfaqeve manipuluese, rrugëve transportuese fraksioneve, sidomos gjatë kohës me erëra dhe temperatura të larta.</li> <li>• Çdo herë kompanija posedon ujë rezervë për spërkatje.</li> </ul> |
| 4.6. | Monitorimi i emisioneve                    | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Qëllimi i monitorimit të emisioneve nga veprimtaria e gurthyesit gëlqeror është që të shohim efektet e kësaj veprimtarie, marrjen e masave preventive për zbutjen e ndotjes së ajrit dhe sjelljen e tyre në nivele sipas legjisacionit.<br/>Emision: PM-10µ,</li> </ul>  |
| 4.7. | Monitorimi i emisioneve/ cilësisë së ajrit |   |
| 4.8. | Raportimet                                 | Sipas kërkesës së Ministris do ti bëjm Raportimet.  |
| 4.9. | Masat për zvogëlimin e ndotjes së ajrit    | <p>Për të parandaluar e zvogëluar sasinë e ndikimeve negative të mundshme në ajër të krijuara nga realizimi i proceseve teknologjike për shfrytezimin e gurit gëlqeror kemi ndermarr këto masa:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Në miqjen sipërfaqesore, gjatë shpimit makina shpuse rregullisht aplikohet thithësi i pluhurit, gypi thithësit të pluhurit vendoset ne skaj të vrimës që shpohet për të grumbulluar pluhurin e liruar në thes për pluhur.</li> </ul>   |

|  |  |   |
|--|--|---|
|  |  | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Nuk bëjm minim në kohëra me erëra.</li> <li>• Të gjitha sipërfaqet operacionale dhe rrugët (pjesët e pa asfaltuar) ku do që bëhet transportimi i masës shkëmbore vazhdimesht e bëjm stërpikjen me ujë.</li> <li>• Vazhdimesht bëhet kontrollimi i rregullt teknik i automjetev të rënda punuese më qëllim që lirimi i gazrave nga mjetet e punës të jetë sa më kualitativë.</li> <li>• Kamionët të cilët bëjnë transportin e frakcioneve mbulohen me mbules adekuate.</li> </ul> <p>Rregullisht kem në disponim cisterna me ujë rezervë.</p> |
|--|--|---|

| <b>5. UJI</b> |   |  |
|---------------|---|--|
| 5.1.          | Të dhënat për shfrytëzimin e ujit   | Furnizimi me ujë në kompleksin e kompanis Benita Company sh.p.k. per nevoja sanitare bëhet nga rezervaret, kurse uji për spërkatje sigurohet me autocisterna.  |
| 5.2.          | Të dhënat për shkarkimin e ujërave, shkarkimet në ujërat sipërfaqësorë apo në rrjetin e kanalizimit | Në hapësirat e licencës se shfrytëzimit : <ul style="list-style-type: none"> <li>- ujërat e ndotura nga larja e mekanizmit të lartë dhe pastrimi i hapësirave punuese rrëth gurëthyesit me separator</li> <li>- ujërat e ndotura sanitare dhe fekale</li> <li>- ujërat nga sipërfaqet manipuluese</li> </ul> Gjatë punës së Licences se shfrytëzimit te gurit gelqeror ndotëja e ujit pjesërisht shkaktohet edhe nga lëshimi i ujërave të zeza nga kumuniteti të pa trajtura, pasi që nuk ekzistojnë objektet industriale ne këte lokacion, prandaj pasi nuk ka ndotës potencial të ujërave, mund të konkludojëm se pastërtia e ujit ne këte lokacion është në nivel të lakkushëm. |
| 5.3.          | Ndikimet në ujë   | Ndikimet në ujë ndikon pluhuri i cili bartet me anë të reshurave atmosferike, ndikim negativ ne ujë shkaktohen nga derdhja e ujërave të zeza, mbeturinat e ndryshme etj.   |
| 5.4.          | Emisionet e ujërave të ndotura - treguesi i emisioneve kryesor                                      | Nga larja e gurit gëlqeror. Nuk ka të dhëna për koncentrimin dhe sasinë vjetore të ndotësve në ujë.  |
| 5.5.          | Trajtimi i ujërave të ndotura   | Nuk bëjm trajtim të ujrat të ndotura sepse nuk kemi ujra të ndotura  |

|       |   |  |
|-------|---|--|
|       |   |  |
| 5.6.  | Kontrolli dhe matjet                      | Sipas kërkesës së Ministris  |
| 5.7.  | Raportimi                                 | Sipas kërkesës së Ministris do ti bëjm Raportimet.   |
| 5.8.  | Leje ujorë për shfrytëzim të ujit         | Nuk posedon Leje Ujore për shfrytëzim  |
| 5.9.  | Leje ujorë shkarkimin e ujërave           | Nuk posedon Leje Ujore për shkarkimin e ujërave të ndotura   |
| 5.10. | Masat për zvogëlimin e ndotjes së ujërave | Uji i cili perdoret për depluhrim dhe spërkatje është ne masë te paket, dhe ky ujë mbetet ne fraksione |

| <b>6. ZHURMA</b> |                      |   |
|------------------|----------------------|---|
| 6.1.             | Burimet              | <p>Zhurma, si element në teknologjinë e shfrytëzimit të gruit gëlqerorë ka një karakter lokal dhe pa ndikim në zonat e banuara, duke pasur parasysh largësinë e tyre nga lokacioni.</p> <p>Zhurma vjen si rezultat i aktivitetev minierare kryesisht nga makinat gjatë procesit të shpimit, minimit, ngarkimit, transportit etj.</p> <p>Me shfrytëzimin e paisjeve prodhues bashkohore në bazë të standardeve të zakonshme maksimumi i zhurmës në burim duhet të jetë 90Db.</p> <p>Zhurma për zonën e banuar është plotësisht në kufijtë e standaridit dhë gjatë ditës nuk do të kalon 50Db, kurse gjatë natës nuk do të punohet.</p> |
| 6.2.             | Kontrolli dhe matjet | Deri me tani nuk kemi bër matje sepse distanca e objekteve për rreth është shume e largët. Nese kërkohet nga Ministria e bejm.  |
| 6.3.             | Raportimet           | Deri me tani nuk kemi bër Raportime sepse distanca e objekteve per rreth është shume e largët. Nese kërkohet nga Ministria e bejm   |

## 7. TOKA

|      |  |   |
|------|--|---|
| 7.1. | Ndikimet në tokë                         | <p>Ndikim negative nga mbeturinat e lëngëta të cilat shkaktohen nga derdhja e vajrave dhe deriveateve të ndryshme nga mjetet e punës gjatë furnizimit dhe punës së tyre.</p> <p>Si ndikime kemi edhe mbeturinat e ngurta të cilat krijoen gjatë procesit të mirëmbajtjes dhe riparimeve të mekanizmit punues, mbeturinat e ndryshme organike dhe jo organike të cilat i krijojnë puntorët. Ndikim tjetër me rëndësi në tokë paraqitet depozitimi i pluhurit i cili krijohet nga procesi teknologjikë, si dhe me ngjeshjen e tokës të cilën e shkaktojnë makinat punuese.</p>  |
| 7.2. | Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë | <p>Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në tokë dunga realizimi i proceseve teknologjike për shfrytëzimin e gurit gëlqeror duhet marrë këto masa mbrojtëse:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Masa bimore e larguar duhet të deponohet në vënde të caktuar për shfrytëzimin e mëtutjeshëm si dhe mos të lejohet kalbja e tyre.</li> <li>• Pjesëm humusore dhe argjilore të materialit steril duhet depunohet në vënde të posaçëm me qëllim të ruajtjes për rikultivim biologjik.</li> <li>• Varësish nga fronti i punëve në miniera, në kohën më të shkurtër që është mundur duhet të filloj procesi i rikultivimit, me ç'rast e tërë sasia e sterilit e cila mbetet do të përdoret për mbushjen dhe nivelizim të hapësirave të krijuara nga proceset e shfrytëzimit të gurit gëlqeror.</li> <li>• Të ndërpritet puna në kohra me të reshura atmosferike me qëllim të mos ngjeshjes në masë të madhe të tokës.</li> <li>• Duhet të merën masta e nevojshme për mos leshuarjen e pa kontrolluar të deriveateve dhe vajrave nga makinat dhe paisjeve prodhuase.</li> <li>• Vaji i makinave të ndërrohet në vënde të caktuara dhe të izoluara për mos depërtimin e tyre në tokë.</li> </ul> |

|      |  |  |
|------|--|--|
|      |  | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Nëse detyrimisht duhet të bëhet ndërrimi i vajit në lokacionin ku shfrytezohet guri gëlqeror për shkak të avarive ne makinat ngarkuese dhe transportuese, atëher duhet siguruar enët adekuate për mbajtjen e vajit dhe duhet siguruar një pjesë nga materiali jo lëshues i vajrave dhe të vendoset nën makinë që riparohet.</li> <li>• Mbeturinat e lëngta që krijohen nga ndërrimi i vajrave të paisjeve duhet të deponohet në enë të posaçme të cilat mbeturina do të i shiten kompanive të licencuara për grumbullimin e vajrave të përdoruara.</li> </ul>   |
| 7.3. | Përshkrimi i rehabilitimit të zonës pas përfundimit të aktivitetit | <p>Trajtimi i rikultivimit në përputhje me kërkuesat bashkohore të mbrojtjes dhe regjenerimit të mjedisit, duhet parë si një prioritet të rëndësishem edhe në këtë region ku zhvillohet veprimtari minerare.</p> <p>Zgjedhja e modelit të rikultivimit varet nga: Qëllimi i rikultivimit i cili nënkupton që pas përfundimit të punimeve minerare, sipërfaqeve të degraduara, prapë tu kthehet funksioni i saj primar ( prodhimi i biomasës), dhe kështu zvogëlohet ndikimi negativ i këtij projekti në ekosistem.</p> <p>Planifikimi i shfrytëzimit të tokës- planifikohet që toka në lokalitet të miqes të rikoltivohët duke iu përshtatur gjendjes se përafërt me atë të mjedisit ekzistues. Të gjitha aktivitetet e lartëshënuara synojnë objetivat e rikultivimit që kanë këto qëllime:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Prodhimi i biomasës – drurit.</li> <li>• Rehabilitimin e pizazhit dhe kthimin e pamjes vizuale në harmoni me formën relefore të terenit.</li> <li>• Kthimin e profilit pedologjik të tokës së degraduar me rastin e punimeve minerare.</li> <li>• Zgjerimi i kapacitetit filtrues natyror të ajrit.</li> <li>• Pyllëzimi i sipërfaqeve të ç'veshura si pasoj e punimeve minerare.</li> <li>• Krijimin e një pizazhi të bukur, të përafërt me atë natyrës përreth.</li> </ul> |

## 8. MENAXHIMI I MBETURINAVE

8.1. Përshkrimi i llojit të mbeturinave dhe klasifikimi sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave

| Mbeturina | Emri i mbeturinës                 | Shkalla rrezikshmërisë | Lloji i deponimit |
|-----------|-----------------------------------|------------------------|-------------------|
|           | Letra                             | Jo të rezikshme        | Kontejner         |
| 13 01     | Vajra dhe lubrikante te perdonura | Te rezikshme           | bure              |
| 13 02     |                                   |                        |                   |

Mbeturinat te cilat do të gjenerohen Gjatë aktivitetit te Kompanisë „Benita Company” Sh.p.k. , Shfrytëzim i gurit gelqeror në Vërbnica te ashtuquajtura mbeturinat komunale deponohen në kontanjer dhe pastaj barten me kamionë nga kompanitë e licencuar, të cilat i dërgojnë në deponit regionale. Vajrat motorike dhe ato të mirëmbajtjes të paimeve të kompanisë deponohen në fuçi dhe ato dorezohen tek ndërrmarrjet e licencuara për grumbullimin e vajrave të përdorura.

|      |  |   |                              |                  |                        |  |
|------|--|---|------------------------------|------------------|------------------------|--|
|      |  | 17 02 03  | Plastika                     | Jo të rezikshme  | Kontejner përmbeturina |  |
|      |  | 15 01 01<br>20 01 01<br>20 01 08  | Mbeturinat e ngurta komunale | Jo te rrezikshme | Kontejner përmbeturina |  |
| 8.2. | Përshkrimi i magazinimit apo deponimit të mbeturinave  | Nuk behet pranimi dhe klasifikimi i mbeturinave sipas llojeve   |                              |                  |                        |  |
| 8.3. | Përshkrimi për trajtim, përpunim dhe riciklimi të mbeturinave                                | Të dhënata janë te operatori i kontraktuar i licencuar  |                              |                  |                        |  |
| 8.4. | Dërgimi për trajtim dhe riciklim të operatori tjetër-kontratë me kompaninë me leje përkatëse | Po, Kontrata është me operator të licencuar   |                              |                  |                        |  |
| 8.5. | Plani për menaxhimin e mbeturinave   | Nuk është i nevojshëm. Mbeturinat me vajra dhe materialet me vajra i dorëzohen operatorit të licencuar pas mirëmbajtjes së pajisjeve. |                              |                  |                        |  |
| 8.6. | Raportimi  | Nese kerkohet nga ministria e bejm  |                              |                  |                        |  |


## 9. RREZIKU NGA AKSIDENTET

|   |  |
|---|--|
| 9  Plani për pengimin e aksidenteve në rast të rrezikut/ plani i intervenimit të brendshëm dhe të jashtëm | <ul style="list-style-type: none"> <li>- Pasi që në aktivitetin e mihjes sipërfaqësore mekanizmi i punes është i mirëmbajtur mirë, dhe të monitoruar nga ekspertët e lamine përkatëse dhe një herit kur dihet se brenda veprimtarisë prodhuase nuk kemi të bëjmë me materje të rrezikshme përmjedisin, por thjeshtë me materila që e marrim nga ky mjedis. Ne si kompani gjatë procesit teknologjik të shfrytezimit shkojm sipas projektit të bër për shfrytëzimin e gurit gëlqeror, duke pasur parasysh se gëlqeroret kan një fortësi të madhe gjasat për shembje të curve jan shumë të vogla sepse kemi kujdes të theksuar në lartësin e shkallës punuese, kedin e shpatit punes gjeresin e shkalles punuese. Zona është e rrethuar, kemi sheja paralajmruse të rrezikut si dhe është bër trajnimi i puntorve përsiguri dhe mbrojteje ne pune si dhe i kemi të paisur të gjithë puntorët me pajisjet personale mbrojtëse : Helmetat mbrojtëse, uniforma, këpucet adekuate, dorëzat, syzat mbrojtëse. Kure bejm minim i ndermarrum te gjitha masat parandaluse përpengimin e aksidenteve të mbrendshem dhe të jashtëm: e kontrollojm terenin mirë e largojm personelin nga zona e rrezikut, makinat jepim alarm, i bllokojm rrugët qe të mos ket levizje pasi që të vertetohem se gjithçka është në rregull atëher kryhet procesi i minimit.</li> </ul> <p>Plani i intervenimit të brendshëm dhe të jashtëm</p> |
|---|--|

|   |   | <pre> graph TD     A[Impakti në punëtorin: lëndim, dëmtim, sëmundje, helmim etj.] --&gt; B[Pas identifikimit]     B --&gt; C[Nëse është e mundur qëndroni dhe ndihmojeni viktiminë të qëndroj e qetë dhe konfir]     C --&gt; D[Praktikojeni ndihmën e shpejtë nëse jeni kompetent]     D --&gt; E[Varrësish prej situatës lajmëroni: Policinë 112.192, Ambulancën 194, Zjarrfikësit 193 etj.]     E --&gt; F[Ekipi i sigurisë ose/dhe policia, zjarrfikësit do të izolojnë hapësirën e rezikuar deri në sigurimin e plotë për vazhdimisë të punës.]     F --&gt; G[Të gjitha informata nga terreni nga gjith stafi të raportohen te ISO menaxheri për raportim] </pre> |         |                                     |   |   |
|---|---|---|---------|-------------------------------------|---|---|
| 9   | Përdorimi i substancave të rrezikshme kimike dhe preparateve, planifikimi i masave për zëvendësimin e tyre  | Nuk përdoret asnjë substancë e rrezikshme kimike.   |         |                                     |   |   |
|   |   | <table border="1"> <thead> <tr> <th>Rreziku</th><th>Përshkrimi i masave që duhet merren</th></tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Vjedhja e lëndës plasëse apo mjeteve inicuese</td><td>Gjatë manipulimit me lëndë plasëse marrin pjesë punëtorët e autorizuar nga personi përgjegjës për fushën e minimit.I gjithë procesi i punës në fushën e minimit deri në inicimin e fushës duhet të përcillet nga personi përgjegjës për atë fushë të minimit.</td></tr> </tbody> </table>   | Rreziku | Përshkrimi i masave që duhet merren | Vjedhja e lëndës plasëse apo mjeteve inicuese | Gjatë manipulimit me lëndë plasëse marrin pjesë punëtorët e autorizuar nga personi përgjegjës për fushën e minimit.I gjithë procesi i punës në fushën e minimit deri në inicimin e fushës duhet të përcillet nga personi përgjegjës për atë fushë të minimit. |
| Rreziku                                       | Përshkrimi i masave që duhet merren   |   |         |                                     |   |   |
| Vjedhja e lëndës plasëse apo mjeteve inicuese | Gjatë manipulimit me lëndë plasëse marrin pjesë punëtorët e autorizuar nga personi përgjegjës për fushën e minimit.I gjithë procesi i punës në fushën e minimit deri në inicimin e fushës duhet të përcillet nga personi përgjegjës për atë fushë të minimit. |   |         |                                     |   |   |

|   |   |  |
|---|---|--|
|   | <b>Qasja e personave të paautorizuar</b>                      | Për të mos lejuar që të kenë qasje në lende plasëse dhe mjete inicuese persona të paautorizuar, duhet që këta persona mos të lejohen t'i afrohen lëndëve plasëse dhe mjeteve inicuese pa lejen e personit përgjegjës për ato lëndë plasëse dhe mjete inicuese.   |
|   | <b>Hedhje t e gurëve</b>                                      | Për të mënjanuar rrezikun e hedhjes së gurëve është e nevojshme që të përcillet mire mbushja e shpimeve dhe të mos mbingarkohen me lëndë plasëse, gjithashtu taposja të bëhet me material nga gurthyesi, fraksion 4 – 8 mm.  |
|   | <b>Lidhja e fushës</b>  | Lidhja e fushës duhet të bëhet në atë formë që mos të lejoj zvogëlim të vijës më të vogël rezistuese në drejtim të objekteve me qëllim të parandalimit të hedhjeve të gurëve.  |
|   | <b>Sigurimi i terrenit</b>                                    | Pasi që të kryhen të gjitha proceset e plasjes deri tek pjesa e inicimit të fushës, duhet që të bëhet sigurimi i terrenit përreth fushës së plasjes, deri në atë pjesë ku parashihet që të jetë e sigurt, e në këtë rast duhet të mbyllen të gjitha rrugët që të shpjinë në qendër të fshatit apo ndryshe tek vendi qe do te kryhet minimi.  |
| 9 | Masat për parandalimin e aksidenteve dhe zvogëlimi i pasojave | <p>Për të evituar rreziqet aksidenciale gjatë shfrytëzimit të gurit gëlqeror duhet ndërrmar këto masa:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Magazionimi i materjeve të rrezikshme, dëmshme dhe ruajtja e tyre sipas rregullave të parapara.</li> <li>• Të gjitha pajisjet dhe instalimet janë konform standardeve më të larta, rradhitja e tyre, shënjimi, signalizimi, etj.</li> <li>• Mirëmbajtja e rregullt, periodike e kushteve të punës dhe mjedisit.</li> <li>• Nëse konstatohet niveli më i lartë i pluhurit, zhurmës, etj. Të merren masa që të njejtat të sjellen në gjendje normale të punës.</li> <li>• Respektimi i legjisacionit në fuqi për mbrojtjen në punë dhe mjedis.</li> <li>• Trajnimi i të punësuarve</li> <li>• Minimi kryhet duke marr të gjitha masat e sigurimit.</li> <li>• Gjatë minimit i vendosim rojet për gjatë kufirit të zonës së sigurisë.</li> <li>• Gjatë minimit i largoimr punorët dhe makinat nga zona e rrezikshmërisë.</li> <li>• Bëhet plani i mborjtjeve nga zjarri.</li> <li>• E tërë fusha e shfrytëzimit është thurur me tel gjembor.</li> </ul> |

|                                   |   |
|-----------------------------------|---|
| 9 Raporti mbi gjendjen e sigurisë | <p><b>Masat që duhet të merren në raste aksidenti</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të merren masat për evidentimin e derdhjevetë deriveve të naftës dhe vajit nga makinat transportuese dhe ngarkuese.</li> <li>• Pronari është I detyruar të mbanë evidencën dhe ruan shënimet për dërgimin e tyre ne qendrat e licencuara për riciklim, për sasinë dhe llojin e mbeturinave të seleksionuara, dhe sasinë dhe llojin embetjeve ngambeturinat, me qëllimqë të vërtetohet dalja e mbeturinave ne këtë lokacion(vendi për grumbullimin e mbeturinave).</li> <li>• Evidencia dhe shënimet duhet të mbahen sipas rekomandimeve që jepen ne Ligjin për Mbeturin Nr. 02/L-30 dhe Udhëzimeve administrative për mbeturina tëhartuara sipas rekomandimeve nga Ligjin për Mbeturina Nr. 04/L-060</li> <li>• Në rastet kur kemi rrjedhje të vajrave dhe fluideve si mbeturina specifike që mundë të ndodhin gjatë procesit, atëherë lëngu i derdhur duhet të pastrohet me absorbues kimik të cilat melopata mblidhen dhe futen në fuqi kumbafen në depo derisa të merën nga kompanitë e licencuara për trajtimin e tyre.</li> <li>• Në mënyrë permanente të mirëmbahet ambienti në kompleks E tërë sipërfaqja e gurthyesit është e rrethuar me tel rrjetor</li> </ul> |
| 9 Plani për mbrojtjen nga zjarri  | <p><b>MASAT PRAKTIKE DHE TEKNIKE PËR SHUARJEN E ZJARRIT</b></p> <p>Shkaqet e ndezjes së zjarrit duhet të dihen dhe mënjanohen, ose të pakësohen. Duhet të ndërtohet sistemi i pajisjeve kundër zjarrit me anë të ujit dhe mjeteve tjera kimike. Të mëren masat e sigurisë kundër venjes së qëllimshme të zjarreve.</p> <p>Planifikimi dhe përgatitja paraprake:<br/>Masat e reagimit në rast rreziku.</p>   |



+

## **10. MASAT NË RASTET E PUNES JO STABILE TË IMPIANTIT**

|       |   |   |
|-------|---|---|
| 10.1. | Ndërprerja momentale e punës së impiantit | Gjatë avarive të pa planifikuara, miëmbajtjes së regulltë dhe reagimit të sistemit të mbrojtjes të pajisjeve. |
| 10.2. | Ndërprerja e punës                        | Vetëm në sezonen dimerore përshkak të kushteve atmosferike.   |

## **11. NDIKIMI I MUNDSHËM I NDOTJES NË SHËNDETIN E NJERIUT**

Zbatimin e masave mbrojtëse të cilat u cekën më lartë të gjitha materiet të dëmshme mund të vihen në kufij të duhur dhe kontrollohen me lehtësi. Ndiçimi i shfrytëzimit të gurit gëlqeror në: kushtet mikroklimatike, emisionit të pluhurit në punishte, mjedis, gazrave, zhurmës, ujëra, florë-faunë nuk është i dëmshëm.

**Personi përgjegjës për mjedis**  
**Emri mbiemri**  
**Armend Prekadini**

**Nënshkrimi**

**Personi përgjegjës i kompanisë**  
**Emri Mbiemri**  
**Negjat Kalludra**

**Nënshkrimi**




Foto 1. Lokacioni





Foto 2.Rrethoj e lokacionit ku behet shfrytëzimi i gurit gëlqeror



Mbeturinat metalike, gomat, shiritat transportues, fuqitë (buret) të vajrave (Foto 3)